

STATUT I SHOQËRISË
“Metropol East“ shpk

Ne Tirane, sot me date 29 / 02 /2024, ne:

1.Z.Dritan MALO, i biri i Tahir, i datelindjes 08.02.1969 ,lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr.G90208050E personal,

2.Z.Dritan Ballgjini i biri i Petritit, i datelindje 18.08.1979, lindur ne Ballgjin Alb, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar i identifikuar me leternjoftimin me nr 035014539 dhe nr H90818183B personal me date leshimi 30.10.2019 ,

3.Brendi ÇELA, e bija e Bledar, i datelindjes 21.06.2001, lindur ne Lushnje, madhore me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr.K15621096C personal;

ne cilesine e “ortakeve themelues” deklarojme se me vullnet të lire të plete e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit “, ne ate Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, hartoje statutin e shoqerise **“Metropol East“ shpk**

KREU I

Neni 1- Krijimi

Shoqeria **“Metropol East“ shpk** , është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2 - Personaliteti juridik

Shoqeria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria **“Metropol East“ shpk** , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaket **Dritan MALO, Dritan Ballgjini** dhe **Brendi ÇELA** te cilet përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3 - Selia

Shoqeria e ka selinë ne adresën “Ruga e Vilave TEG, perballë Joy Residence, kat 1, Lunder, Tirana”,

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

Neni 4 - Objekti i veprimtarise

Selia:

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

Organizimi i zyrave Real-Estate, ne te gjithe Shqiperine dhe jashte saj, etj.

Bashkepunim juridiko ligjor dhe financiar edhe me biznese e shoqueri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie.

Krijimi, blerja, financimi, investimi, hyrja ne mardhenie te ndryshme me te tretet, kryerja e sipermarrjeve dhe projekteve, ofrimi i sherbime dhe asistences se te gjitha llojeve, personave fizike dhe juridike, perfshi sherbimet menaxhueze, keshilluese, planifikuese, financiare, turistike, teknike, administrative.

Kerkimi, analizimi dhe perzgjedhja e personelit tekniko-administrativ.

Punesimi i personelit te kualifikuar dhe venia ne dispozicion te kompanive nderkombetare. Konsulence juridike me kontraktoret e huaj ne trajtimin e ligjeve shqiptare apo cestje te ndryshme ligjore.

Konsulence me kontraktoret e huaj ne kerkimin e personelit lokal tekniko-administrativ dhe venia ne dispozicionin te kontraktoreve.

Konsulence me kontraktore te huaj dhe vendas per tenderimin e projekteve me financim te huaj. Shoqeria kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj, duke perfshire edhe pjesmarrije ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera

Neni 5- Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore pa afat.

KREU II- KAPITALI

Neni 6- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **20000 (njëzetë) lekë**. Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga ortaket e shoqerise **Dritan MALO, Dritan Ballgjini dhe Brendi ÇELA**.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaket përgjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7- Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakeve te Shoqerise në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 8- Kuotat

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që trjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

Selia:

- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Transferimi i kuotave te te tretet kufizohet me miratim te asamblese se ortakeve në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

- Dritan MALO, ne kete shoqeri do te kete 1 (nje) kuote me 30(tridhjete) % te kapitalit te shoqerise.
- Dritan Ballgjini ne kete shoqeri do te kete 1 (nje) kuote me 30(tridhjete)% te kapitalit te shoqerise.
- Brendi Çela ne kete shoqeri do te kete 1 kuote me 40 (dyzete) % te kapitalit te shoqerise.

KREU II- ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRESE

Neni 9- Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te peraktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistraura në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundretojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Selia:

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise mund të zhvillohet me pjesëmarrjen e ortakeve në vende të ndryshme, të lidhur me instrumenta e mjete të telekomunikimit, në përputhje me metodat normale të telekomunikimit, duke përfshirë këtu mënyrën elektronike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit, që marrin pjesë në telekonferencë dhe/ose video-konferencë dhe/ose me mënyra të ngjashme elektronike, të mund të identifikohen dhe t'u jepet atyre mundësia të kryejnë e të marrin pjesë në diskutime, të marrin, dërgojnë dhe vlerësojnë dokumentacionin e përdorur gjatë mbledhjes.

Neni 10- Administrimi

Administrator i shoqërisë është ortaku **Brendi Çela** per një periudhe 5 (pese) vjecare.

Shoqëria mund të administrohet nga një Administrator i Vetëm ose nga dy a më shumë Administratorë, të cilët ushtrojnë të drejtat e dhëna atyre së bashku apo më vete.

Asambleja zgjedh sistemin e administrimit dhe në rast se ka më shumë administratorë, cakton numrin e tyre, që nuk duhet të kalojë pesën, si dhe të drejtat përkatëse.

Administratorët edhe mund të mos janë ortakë dhe janë të rizgjedhshëm.

Kohëzgjatja e tyre në detyrë është për një kohë të pakufizuar, deri në revokim apo dorëheqje, ose për një periudhë të caktuar herë pas here nga asambleja.

Administratorëve u takon pagimi i shpenzimeve të kryera për arsyet e punës së tyre. Asambleja e ortakeve te Shoqerise gjatë emëritimit ose me vendim të vlefshëm deri në ndryshimin e tij, mund të caktojë për ta një pagesë.

Neni 11- Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- kujdeset përmbiqet e saktë e të irregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmbiqet e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmbrëtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakeve edhe ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e

- shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpëra të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhëniet me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori perfaqeson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjafqueshme.

Administratorët mund të emërojnë agjentë apo përfaqësues, për akte apo kategori aktesh të caktuara. Në çdo rast, kur përfaqësimi i shoqërisë i kalon një subjekti, që nuk është administratori, caktimi i të drejtës së përfaqësimit të shoqërisë rregullohet nga dispozitat e një prokure te përgjithshme apo te posacme.

Neni 12- Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortakeve te Shoqerise që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdis;
- të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Selia:

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të këruara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13- Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Neni14 - Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve te Shoqerise, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve te Shoqerise vendos rrith shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15 - Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimitarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithesvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve te Shoqerise .

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 16

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondevit ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

Neni 17

Selia:

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kobe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve te shoqerise
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket e Shoqerise marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakeve te Shoqerise .

Nëse Ortaket e Shoqerise nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvçese kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 19 - Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20 - Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin

Selia:

e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 21 - Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjeter ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22 - Ndarja

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakeve te Shoqerise , duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërise ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me reportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta
- b) bërjen e aksionerëve/ortakëve të shoqërisë që ndahen aksionerë apo ortakë të një ose më shumë shoqërise pritëse, në përputhje me reportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23- Shnderrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24- Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25 - Mosmarreveshjet

Selia:

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26 - Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 4 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet me vullnetin e tij te lire nga ortaket themelues.

ORTAKET E SHOQERISE "Metropol East" shpk

1.Dritan MALO

Dritan Malo

2.Dritan Ballgjini

Dritan Ballgjini

3.Brendi ÇELA

Brendi Çela